VENDIM
Nr. 666, datë 10.11.2021

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 893, DATË 17.12.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË ORGANIZIMIT DHE TË FUNKSIONIMIT TË KABINETEVE NDIHMËSE, TË ORGANIZIMIT TË BRENDSHËM TË INSTITUCIONEVE TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE, SI DHE PËR PROCEDURAT E HOLLËSISHME PËR PËRGATITJEN, PROPOZIMIN, KONSULTIMIN DHE MIRATIMIN E ORGANIZIMIT TË BRENDSHËM"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17, pika 2; 21, pika 5, dhe 29, pika 1, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 29, të vendimit nr. 893, datë 17.12.2014, të Këshillit të Ministrave, të shtohen pikat: 29/1, 29/2, 29/3, 29/4 dhe 29/5, me këtë përmbajtje:

"29/1. Në institucione të sistemeve prioritare, sipas përcaktimit të Kryeministrit apo të Këshillit të Ministrave, në kuadër të miratimit të strukturës dhe organikës së tyre, krijohen qendrat e ekselencës, të dedikuara:

a) për të propozuar dhe/ose menaxhuar projekte apo iniciativa zhvillimore në fushat përkatëse;

b) për të kontribuar me njohuri dhe ekspertizë të posaçme, të nevojshme për një periudhë të caktuar kohore, në fushën që mbulon institucioni e për të cilën mungojnë kapacitetet e nevojshme në institucion.

29/2. Numri i pozicioneve të punës në qendrat e ekselencës, të krijuara si pjesë e strukturave dhe organikave të institucioneve të administratës shtetërore, sipas pikës 29/1, të këtij vendimi, të jetë jo më shumë se 5 (pesë).

29/3. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve në qendrat e ekselencës të rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

29/4. Procesi i përzgjedhjes së kandidatëve për punësim në qendrat e ekselencës menaxhohet nëpërmjet platformës "Gati për Shqipërinë", nga komisionet e krijuara përkatësisht pranë Kryeministrisë apo ministrive, që kanë në sistemin e tyre këto njësi organizative. Ky proces realizohet nëpërmjet një procedure konkurruese, e cila zhvillohet në 2 (dy) faza:

a) Aplikimi i kandidatëve nga brenda apo jashtë Shqipërisë:

i. me ide për projekte apo iniciativa zhvillimore në fusha të caktuara, në rastin e përcaktuar në shkronjën "a", të pikës 29/1, të këtij vendimi;

ii. me ekspertizën e nevojshme në fushën për të cilën nevojitet ajo, në rastin e përcaktuar në shkronjën "b", të pikës 29/1, të këtij vendimi;

b) Vlerësimi i kandidatëve, nëpërmjet intervistave me gojë, ku anëtarët e komisioneve përkatëse gjykojnë për:

i. përputhshmërinë më të mirë të projekteve apo iniciativave zhvillimore të propozuara nga kandidatët me objektivat strategjikë të institucionit përkatës;

ii. ekspertizën më të mirë, në fushën ku është e nevojshme të ofrohet ajo.

29/5. Emërimi i kandidatëve, të përzgjedhur sipas pikës 29/4, të këtij vendimi, bëhet në njërin prej niveleve të ekspertëve në bazë të kritereve të mëposhtme:

a) Ekspert i kategorisë së parë – kandidati që ka të paktën 5 (pesë) vjet ekspertizë në fushën për të cilën ka konkurruar, të vërtetuar në kontratat përkatëse;

b) Ekspert i kategorisë së dytë – kandidati që ka deri në 5 (pesë) vjet ekspertizë në fushën për të cilën ka konkurruar, të vërtetuar në kontratat përkatëse.”.

2. Ngarkohen Departamenti i Administratës Publike dhe institucionet e administratës shtetërore për zbatim e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama